



Drejtoria për Inspekcione

10 Nr. ____ /2023

Dt. 11 / 07 /2023

Për: Bashkim Ramosaj-Kryetar i Komunës

Nga: Halil Tolaj – Drejtor i Drejtoratit për inspekcione

Lënda: Raport i punës së Drejtoratit për Inspekcione për gjashtëmuorin e parë 2023.

Drejtorati për Inspekcione i Komunës së Deçanit gjegjësisht inspektorët e këtij Drejtorati, gjate gjashtëmuorit të parë të vitit kalendarik 2022 kanë kryer punët dhe detyrat e punës mbështetur në Ligjet dhe aktet nënligjorë si dhe rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të punës së Drejtoratit për vitin 2023.

Në Kuadër të Drejtoratit gjatë këtij gjashtëmuori kanë qenë të sistemuar Inspektori i Tregut, Inspektori i Mbrojtjes së Ambientit, Inspektori i Ndërtimit (me Kontratë mbi shërbimet e Veçanta), Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta) dhe Inspektori i Bujqësisë që njëkohësisht është edhe shëf i inspektorëve.

Secili nga Inspektorët ka vepruar sipas detyrës zyrtare, sipas kërkesave dhe ankesave të palëve dhe sipas kërkesave të organeve tjera kompetente. Në mënyrë permanente është bërë mbikëqyrja inspektuese e subjekteve tregtare dhe hoteliere me theks të veçantë lidhur me respektimin e orarit të punës, vendosjen e çmimeve të mallrave për tregtim, afati i skadimit të produkteve ushqimore, ndërtime pa leje apo në kundërshtim me lejen ndërtimore të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Në mënyrë permanente është bërë kontrolli i therjes së kafshëve në thertoret e licencuara.

Sipas kërkesave të operatorëve ekonomik është bërë pranimi i lokaleve të subjekteve sa i përket kushteve minimale higjienike teknike dhe të mbrojtjes në punë.

Janë bërë kontrole sipas kërkesës së Policisë së Kosovës (me të cilët ekziston një bashkëpunim mjaft i mirë), posaçërisht për mallrat e hasura në transportin rrugor pa dokumente përkatëse përcjellëse, mosrespektimin e orarit të punës sidomos nga subjektet hoteliere, por edhe sipas denoncimit të palëve në polici për pa rregullsitë e hasura të subjektet tregtare sidomos nga lëmi i çmimeve dhe afati i skadimit të artikujve ushqimor.

Janë kryer edhe punë tjera sipas fushe veprimtarisë të secilit nga inspektorët.

Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve:

Inspektori	Kontroll inspektuese në teren sipas detyrës zyrtare	Kontroll inspektuese në teren sipas kërkesës së personave fizik dhe juridik	Procesverbale të hartuara për konstatimin e gjendjes	Aktvendime	Kërkesa për gjykatat kompetente
I Tregut	17	22	45	5	2
I Ndërtimit	14	4	9	1	/
I Mbrojtjes së Ambientit					
I Veterinës	42	13	13	/	/
I bujqësisë	5	6	6	/	/
Gjithsejt:	78	45	73	6	2

Kërkesë: Si çështje e ndjeshme që është lëmia e ndërtimit zgjidhja e çështjes së Inspektorit të ndërtimit.



Drejtori

Halil Tolaj

O. Inspeksionit 19177
 02 23.06.23